

Tiranë, 15.02.17

Nr. Prot. 49

LETËR REFERENCE

Nëpërmjet kësaj Letër Reference, Institucioni i Avokatit të Popullit shpreh konsideratat për bashkëpunimin në interes të të drejtave të fëmijëve me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve (Observatori).

Institucioni i Avokatit të Popullit ka bashkëpunuar me Observatorin në zbatimin e nismës “Fuqizimi i kapaciteteve të Avokatit të Popullit për të vëzhguar dhe adresuar rastet e keqtrajtimit të të miturve në burgim” përgjatë periudhës Gusht 2016 – Dhjetor 2016.

Nëpërmjet zbatimit të kësaj nisme, Observatori ka kontribuar në krijimin e paketës së plotë të metodologjisë bashkëkohore në përshtatje dhe me standardet më të fundit ndërkombëtare, për monitorimin e kushteve në institucionet e paraburgimit, privimit të lirisë për të mitur.

Në zbatimin e kësaj nisme, Observatori ka kontribuar në krijimin e një *mjedisi harmonik dhe bashkëpunues*. Ekspertiza e stafit të Observatorit e gërshetuar me ekspertizën ndërkombëtare kanë shërbyer edhe në hartimin e një raporti mbi vlerësimin e kushteve dhe trajtimit të të miturve në institucionet e ndalimit, paraburgimit dhe burgimit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke u bazuar në eksperiencën shumë të sukseshme të bashkëpunimit, e rekomandon Observatorin si një organizatë partnere dhe shumë aktive në zbatimin e nismave të ndryshme në garantim dhe përmbushje të të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve!

Me respekt,

Z. Iglj Totozani
Avokat i Popullit

